



# Përmbledhje Jo-TEKNIKE

## “Impiant për prodhimin e betonit”

KOMPANIA: Meteo sh.p.k

HARTOI: GR Albania

Shtator. 2018

<b>Titulli i Projektit:</b>	<b>“Impiant prodhim betoni”</b>
<b>Investitori:</b>	<b>“METEO” sh.p.k</b>
<b>Përgatitur nga:</b>	<b>GR ALBANIA sh.p.k :</b> 
 <b>GR ALBANIA</b>	<b>Shtator, 2018</b>

## PËRMBAJTJA

1	Hyrje .....	4
2	Përshkrimi i Projektit .....	5
2.1	Lëndët e para:.....	7
2.2	Përshkrim I mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti .....	8
2.2.1	Hidrografia.....	8
2.2.2	Flora dhe fauna.....	9
3	Identifikimi I ndikimeve në mjedis .....	9
3.1	Metodologjia per vleresimin e ndikimeve.....	9
3.2	Impaktet në mjedis.....	11
3.2.1	Ndikimi në biodiversitet .....	11
3.2.2	Ndikimi në tokë .....	11
3.2.3	Ndikimi në ajër .....	11
3.2.4	Ujëra të ndotura .....	12
3.2.5	Zhurma dhe vibrime .....	12
3.2.6	Gjenerimi I mbetjeve.....	12
4	Masat zbutëse të ndikimeve negative në mjedis .....	12

### Lista e Figurave

Figura 1-1: Vendndodhja e projektit .....	4
Figura 2: Planvendsja e aktivitetit të impiantit .....	5
Figura 3: Pamje nga procese të ndryshme në objekt .....	6
Figura 4 : Paraqitja ciklit të prodhimit të betonit.....	8

### Lista e tabelave

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit.....	10
---	----

## 1 HYRJE

Kompania "METEO" sh.p.k e regjistruar në QKB me nipt L26310801C synon të zhvillojë aktivitetin e prodhimit të betonit. Objekti ndodhet Rruga Nacionale Gramsh – Elbasan, në ndërtesë private, fshati Çekin, Njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan . Ky raport vlerësimi hartohet me kërkesë të subjektit METEO sh.p.k me seli kryesore në Gramsh dhe me përfaqësues ligjor Z. Erind Bengu.

Bazuar në ligjin për Vlerësimin e ndikimit në mjedis nr.10440, datë 07.07.2011, I ndryshuar, ky aktivitet nuk përfshihet në asnjë nga shtojcat e këtij ligji në lidhje me projektet që duhen ti nënshtrohen procedurës paraprake ose thelluar të VNM-së.

Në këtë mënyrë, ky aktivitet do të pajiset vetëm me Leje Mjedisore sipas shtojcës 1, Ligj Nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit". Sipas ligjit Nr. 60/2014: Për një ndryshim në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, klasifikohet Tipi B sipas shtojcës 1 pika 3.1 e).




Figura 1-1: Vendndodhja e projektit

Kapaciteti i prodhimit të betonit nga ky impaint është i ndryshëm nga dita në ditë dhe nga muaj në muaj, pasi prodhimi varet nga kërkesat e klientëve. Për shfrytëzimin e kësaj linje teknologjike janë hartuar projektet teknike përkatëse të ndërtimit, pajisve të instaluara, rrjeteve inxhinjrike etj të cilët janë miratuar nga institucionet ligjore përkatëse. Më poshtë paraqitet planvendosja e impiantit të prodhimit të betonit.




Figura 2: Planvendsja e aktivitetit të impiantit

## 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Linja e prodhimit të betonit përbëhet nga :

- Pulti i komandimit.
- Silloz çimentoje me vëllim 45 m<sup>3</sup>.
- Silloz çimentoje me vëllim 45 m<sup>3</sup>.
- Bunkeri i inerteve me vëllim 100 m<sup>3</sup>

- Peshore e çimentos dhe e inerteve.
- Transportjeri i inerteve

Me termin beton në rastin e përgjithshëm shënohen materialet ndërtimore të përbëra nga agregati / mbushësit (rëra me zhavorin ose granil), mjetit lidhës dhe ujit dhe në disa raste të caktuara dhe shtesa speciale - aditivë. Prodhimi i betonit është një operacion pune i njohur dhe relativisht i thjeshtë sepse ka të bëjë me përzjerjen e tre elementëve përbër të tij që janë inertet, çimentoja dhe uji.



*Figura 3: Pamje nga procese të ndryshme në objekt*

Në raste të veçanta, mund të përdoren edhe shtesa për përmirësimin e cilësisë së kërkuar të një marke betoni. Vetitë apo treguesit cilësorë të betonit varen dhe përcaktohen nga të gjithë lëndët përbërëse të tij, nga lloji dhe sasia si dhe, treguesit cilësor të tyre. Po kështu treguesit cilësor të betonit janë të kondicionuar edhe nga kushtet e transportit, vendosja-shtruarja si dhe kujdesi për betonin. Për prodhimin e këtij lloji betoni, si lëndë lidhëse shfrytëzohet çimento, si agregat mbushës – inerte si dhe uji. Betoni si material ndërtimor veçohet me qëndrueshmëri të lartë ndaj shtypjes dhe qëndrueshmëri të vogël ndaj tërheqjes. Për shkak të këtyre vetive ai mund të përdoret për realizimin e konstruksioneve në të cilat mbizotërojnë tensionet apo forcat në shtypje siç janë: themele, disa lloje të mureve mbështetëse dhe shtylla, blloqe për muratim etj. Linja teknologjike e prodhimit të betonit, vihet në punë herë që ka kërkesa për betone të markave të ndryshme. Eksperienca e punës në shfrytëzimin e saj ka tregu se lina ka punuar mesatarisht gjatë 185 ditëve dhe ka arritur të prodhojë rreth 2100 m<sup>3</sup> beton gjatë një viti kalendarik.

Është një linjë e cili punon tërësisht e automatizuar, në bazë të programeve të instaluar në panelin/pultin e tij të komandimit. Granili me një përbërje granulometrike të caktuar (raporti sasior i përmbajtjes së madhësive të caktuara kokrrizash të lëndës inerte) është i vendosur në depozitën përkatëse të impjantit. Po kështu edhe çimentoja e një marke të caktuar është vendosur në silozët përkatës. Nëpërmjet pultit të komandimit përcaktohen sasitë respektive

të inertit, çimentos dhe uji të cilët dërgohen në përzjerësin mekanik të tyre. Këtu bëhet përzjerja homogjenizuese e të tre këtyre lëndëve për disa minuta dhe pas kësaj, ngarkesa e pregatitur shkon në makinën transportues, e cila gjatë lëvizjes për në destinacion vijon të përzjehë betonin e pregatitur.

#### Ngarkimi dhe transporti i brendshëm:

Ngarkimi dhe transporti i brendshëm në këtë veprimtari janë dy prej proceseve teknologjikë kryesorë. Këtyre dy proceseve ju nënshtrohen të gjitha llojet e materialeve të cilat përdoren si lëndë e parë të tilla si inertet, çimentoja etj, dhe njëkohësisht edhe prodhimet e kësaj veprimtarie si betoni .

Lëndët e para sillen në objekt kryesisht me mjete transporti, të subjekteve të liçensuar për prodhimin dhe transportin e inerteve, çimentos etj.

Transporti i betonit nga linja e prodhimit të tij, në vendin ku ai do të përdoret kryhet me automjetet të specializuar për këtë qëllim. Ngarkimi i automjetit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga linja teknologjike e prodhimit të betonit.

Proçesi i ngarkimit të elementëve prej betoni të prodhuar këtu, kryhet me anë të autovinxhit me kapacitet ngritës e transportues deri 2 ton. Brenda teritorit të objektit gjendet edhe një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që punojnë në këtë veprimtari.

## 2.1 Lëndët e para:

- Agregati / mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli),

Agregati është komponenti më i përfaqësuar në masën e përgjithshme të betonit (75-80%). Sipas vetive fizike dhe kimike të tij ai nuk është material inert për arsye se ka ndikim në vetitë fiziko-kimike të betonit. Për përgatitjen e betonit shfrytëzohet agregat me prejardhje të ndryshme – natyrore dhe artificiale, siç janë: Agregat natyror (rërë, granil te dimensioneve te ndryshme).

- Përdorimi i sasisë së ujit dhe materialeve shtesë.

Uji dhe aditivët hidhen sipas markës së betonit. Uji është elementi që realizon miksimin e tyre me njëra tjetrën duke reaguuar kimikisht me çimenton dhe shtesat e tjera. Shtesat shtohen sipas markës përkatëse të betonit.

- Çimento

Çimentoja transferohet për në impiantin e betonit me kamionët me çisternë të posacëm, ku ajo ruhet në sillosa. Çimento është materiali më i rëndësishëm për procesin e prodhimit të betonit. Hidratimi i çimentos, reaksioni kimik midis çimentos dhe ujit, ndikojnë në ngurtësimin e betonit. Raporti ujë/çimento përcaktojnë tipin e betonit si një element tepër i rëndësishëm,

si vetitë e saj kryesore fortësia dhe qëndrueshmëria. Në varësi të markës së kërkuar, sasia e saktë e çimentos peshohet dhe shtohet në njësinë e përziersit për miksimin së bashku me agregatet e tjerë, ujin dhe aditivët.

- Energji elektrike

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjenteve të punës, rrugëve etj. Energjia elektrike e harxhuar mesatarisht në një muaj është rreth 386 kWh.

- Furnizimi me ujë

Uji është pjesmarrës në proceset teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari, kryesisht për përgatitjen e betonit. Ai përdoret njëkohësisht edhe për plotësimin e nevojave humane, pastrimin e ambjentve të punës etj. Konsumi mesatar i ujit është rreth 105 m<sup>3</sup>/muaj. Për të siguruar mosndërprerjen e furnizimit me ujë, gjatë kohës që punon linja e prodhimit të betonit, është instaluar një depozitë uji me kapacitet 1500 litra.



Figura 2-4 : Paraqitja ciklit të prodhimit të betonit

## 2.2 Përshkrim i mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti

### 2.2.1 Hidrografia

Rrethi i Gramshit ka një hidrografi të pasur si me ujëra sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore, edhe pse burimet aktive gjithëvjetore janë të dendura vetëm nga lartësitë 1000 m mbi nivelin e detit, ndërsa në zonën e poshtme ato janë të rralla. Këtu mund të përmendim dy lumenjtë kryesorë të rrethit Devolli me gjatësi brenda tij 49 km dhe Tomorrica me një gjatësi prej 14 km.



Gjithashtu janë të pranishme edhe disa lumenj të tjerë, por më të vegjël si ai i Holtës, Lenies, etj. Burimi ujqor më i rëndësishëm i kësaj zone/rajonit është lumi Devoll. Ky lumë buron rrëzë malit të Gramozit, në afërsi të fshatit Nikolocë. Vazhdon rrjedhën e vet në veri, drejt qytetit të Bilishtit, për t'u kthyer më pas në perëndim nëpër grykën midis Malit të Thatë në veri dhe Moravës në jug. Përshkon fushën e Korçës duke e ndarë atë gati në mes dhe merr me vete lumin e Dunavecit. Rrjedha e tij, duke përshkruar malësinë e Gorës dhe të Oparit, futet në Rrethin e Gramshit duke kaluar në jug të qytetit. Në afëri të Urës Vajgurore të Qarkut të Beratit bashkohet me lumin e Osumin që buron po nga Gramozi, dhe pastaj të dy bashkë duke formuar lumin e madh të Semanit derdhen në det.

### 2.2.2 Flora dhe fauna

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet në Fshatin Çekin, Njësia Administrative Pishaj ,Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan. Prania e llojeve të ndryshme të tokave si dhe kushtet klimaterike, kanë kushtëzuar edhe zhvillimin e bimësisë, si atë natyrore dhe atë të kultivuar.

Ndër katet bimore mund të përmendim :

- Zonën e dafinës deri në lartësinë 1000 m.
- Zonën e ahut, në lartësinë 1700-1800 m.
- Zonën e rrobullit, në lartësinë 1800-2000 m.
- Zonën e kullotave sub-alpine, në lartësinë 1800-2373 m mbi nivelin e detit.

Ndër kulturat e drithërave, gruri zë peshën specifike më të madhe, rreth 35 % të sipërfaqes së mbjellë. Kushtet klimatike favorizojnë kultivimin e një numëri të konsiderueshëm llojesh perimesh të ndryshme. Zona ka tradita edhe në pemëtarë e vreshtarë. Kështu përmendim kultivimin e rrushit, mollës, dardhat, kumbullat, arrat, gështenjat, ullirin, etj. Veshja bimore, kushtet klimatike, si dhe karakteristikat e tokave, vlerësohen relativisht të përshtatshme për zhvillimin e një faune të pasur të kësaj zone dhe të Gramshit. Administrimi i faunës ekzistuese, mbetet aktivitet në duart e pakontrolluara dhe spontane me rezultate të pafavorshme për këtë pjesë të botës së gjallë të territorit të kësaj zone në të cilën takohen ujku, dhelpra, derri i egër, dhija e egër, gjeli i egër, lepuri etj

## 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

### 3.1 Metodologjia për vlerësimin e ndikimeve

Një metodë vlerësimi duhet të përcaktojë të gjitha ndikimet të cilat lindin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë nga ndërtimi apo nga operimi i projektit dhe gjithashtu duhet të përcaktojë në cilën fazë të projektit lindin dhe cila është kohëzgjatja e tyre.

Për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të cilat parashikohen operimit të projektit është parë e arsyeshme që karakteristikat mjedisore të klasifikohen në tre kategori:

- a) Indikatorët abiotikë
- b) Indikatorët biotikë
- g) Indikatorët social/ekonomik

Grupimi i faktorëve mjedisore ndihmon në nxjerrjen e shpejtë të një konkluzioni për gjendjen e mundshme të mjedisit, ndihmon në ekzaminimin e problematikës duke mos humbur kohë dhe mbi të gjitha jep mundësinë e krahasimit me ndikimet e të njëjtës natyrë në VNM. Në tabelën e mëposhtme paraqitet klasifikimi i faktorëve mjedisore të cilët mund të ndryshojnë në lidhje me fazat e projektit. Në vazhdimet e VNM vlerësohen të gjithë parametrat e poshtëpërmendura

#### Metoda e vlerësimit së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit

Vlerësimi	Përshkrimi
<b>Rëndësia</b>	
<b>Pa ndikim</b>	Nuk egzistojnë ndikimet në mjedis.
<b>Ndikim I papërfillshëm</b>	Ndikimi në mjedis nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim të dukshëm në vlerën e tij dhe aktiviteti i propozuar do të ketë impakt shumë minimal, thuajse të pakonsiderueshëm në implementimin e tij.
<b>Ndikim I ulët</b>	Projekti ndikon pak në vlerat natyrore duke patur parasysh sasinë dhe cilësinë.
<b>Ndikim mesatar</b>	Vlerat mjedisore do të preken për shkak të shkallës së ndikimit dhe ndjeshmërisë. Ndryshimet janë të përkohshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e mjedisit. Duhet të shoqërohet njëkohësisht me masa kontrolluese dhe menaxhuese.
<b>Ndikim I lartë</b>	Ndodh kur aktiviteti ka gjasa të përkeqësojë gjendjen e mjedisit duke cënuar karakteristikat e tij dhe elementet strukturore të vlerave mjedisore. Projekti shkakton ndryshim madhor në vlerat natyrore dhe habitatin e zonës, shpesh duke u shoqëruar me ndikim të pakthyeshëm (efekti negativ do të vazhdojë në mjedis duke sjellë degradim). Rehabilitimi konsiderohet i vështirë në këtë fazë.
<b>Kohëzgjatja e ndikimit</b>	
<b>Afatshkurtër</b>	Parashikohet të zgjase vetëm për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit.

<b>Afatgjatë</b>	Që do të vazhdojnë për gjithë jetën e Projektit, por pushon kur projekti ndalon operimin.
<b>I përhershëm</b>	Impakte të përhershme që shkaktojnë një ndryshim të përhershëm në receptorin ose burimin e prekur.
<b>Kthyeshmëria (Reversibiliteti)</b>	
<b>I kthyeshëm</b>	Gjasat që një parameter I matur mjedisor do të rikuperohet nga impakti mjedisor përmes teknikave të menaxhimit të mjedisit.
<b>I pakthyeshëm</b>	Dhe pse mund të meren masat rehabilituese, mjedisi nuk mund të kthehet sërish në gjendjen e mëparshme.

Ky vlerësim është mbështetur vetëm në disa nga kriteret e listuara më sipër dhe në vecoritë e mjedisit ku do të zhvillohet projekti. Mbi këtë vlerësim do të orientohen edhe masat që duhet të merren për të zbutur ndikimet, të cilat përbejnë dhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

## 3.2 Impaktet në mjedis

### 3.2.1 Ndikimi në biodiversitet

Duhet të përmendim faktin që aktiviteti tashmë është egzistues, pra nuk do të ketë fazë ndërtimore dhe si e tillë nuk do të përbëjë shqetësim apo ndikim në florë dhe faunë. Por, subjekti duhet të marrë masat e duhura në mënyrë që të minimizohet impakti në mjedis. Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë sipas hartës së publikuar nga AKZM-ja.

### 3.2.2 Ndikimi në tokë

Ndotja mund të vijë si pasojë e avarive teknike të makinerive dhe derdhjeve aksidentale (karburante, vajra) të makinerive në mjedis. Mbetjet urbane si: mbetje ushqimore, karton, letër, plastike etj, janë në një të vogël dhe do të hidhen në kontenerët e zonës.

### 3.2.3 Ndikimi në ajër

Pluhurat mund të shkaktohen gjatë shkarkimit të lëndës së parë (zhavor te dimensioneve të ndryshme, granil, rërë etj), si pasojë e faktorëve klimatike (era). Gjithashtu, makineritë e transportit, betonierja si dhe mjete të tjera të cilat do të levizin në vendin e punës do të ndikojnë në rritjen e gazeve në sipërfaqen e objektit. Gjatë përzierjes së materialeve për përgatitjen e formulës së betonit do të sprucohet ujë me qëllim që minimizohet rritja e nivelit të pluhurave.

### 3.2.4 Ujëra të ndotura

Ujërat e ndotura që do të gjenerohen si pasojë e zhvillimit të aktivitetit të prodhimit të betonit do të vijnë nga dy burime: ujërat e ndotura urbane (për qëllime sanitare), dhe ujërat që dalin nga larja e sheshit. Në rrjetin e kanalizimeve shkarkohen vetëm ujrë që dalin nga ambientet hidro-sanitare dhe që përmbajnë ujëra të zeza. Keto ujëra derdhen në rrjetin e kanalizimeve të uzinës së Çekinit, i cili shkarkon drejtpërsëdrejti në ujrë e lumit Devoll. Uji përdoret si element përzierës në beton dhe nuk ka teprica të tij. Ujërat që dalin gjatë larjes së sheshit kryesor orientohen përmes kanaleve përkatëse në vaskën e dekantimit.

### 3.2.5 Zhurma dhe vibrime

Ky impakt do të vijë nga disa burime sikurse janë: makineritë e transportit, betonieret, makineritë e vogla të terrenit, etj. Procesi i impiantit të betonit shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet të jetë në nivele të larta në zonë në të cilën operon. Në mënyrë që impakti të jetë sa më i vogël është e nevojshme që kompania të kryejë monitorim në laborator të akredituar si dhe të respektojë normat e përcaktuara në udhëzimin Nr.8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave". Shfaqja e fenomenit të vibrimeve mund të vijë gjatë lëvizjes së materialit në transportier.

### 3.2.6 Gjenerimi i mbetjeve

Mbetjet urbane si letër, karton, plastikë, mbetje ushqimore janë në një sasi mjaft të vogël, do të hidhen në kosha mbetjesh të cilat menaxhohen nga bashkia. Mbetjet që do të dalin nga procesi i punës janë llumrat pas dekantimit të ujerave teknologjike të vaskës së dekantimit.

Duke qënë se brenda objektit do të kryhet dhe mirëmbajtja e makinerive, mund të krijohen dhe mbetje të tjera si: leckë të ndotura me hidrokarbure / vaj makinerish, goma etj. Transporti i këtyre mbetjeve duhet të kryhet vetëm nga kompani dhe makineri të licensuara me lejet përkatëse si dhe të shoqërohet me dokumentin e transferimit të mbetjeve.

## 4 MASAT ZBUTËSE TË NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Masat zbutëse janë një grup masash të cilat meren në konsideratë paraprakisht në mënyrë që të minimizohen impaktet negative në mjedis dhe të lehtësojë fazën e rehabilitimit.

### **Masat zbutëse që duhet të ndërmerren gjatë aktivitetit:**

Nga vlerësimet e kryera, shkarkimet e pritshme në mjedis janë të ulta dhe nuk përbëjnë problem serioz për mjedisin. Gjithësesi, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe

mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

- Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e rënies së zjarrit në objekt dhe avaritë në sistem duke shmangur ndotjen në mjedis.
- Mbetjet urbane të krijuara gjatë veprimtarisë së karrierës duhet të sistemohen në një vend të përcaktuar brenda saj dhe të largohen në mënyrë periodike në vendet e përcaktuara nga Bashkia Gramsh( në bashkëpunim me subjekte të licensuara).
- Transporti i produktit nga objekti në drejtim të subjekteve që e përdorin atë duhet të bëhet me mjete të përshtatëshme e të mbulura.
- Duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen vazhdimisht kanalet e hapura për disiplinimin e ujrave të rreshjeve të shiut me qëllim parandalimin e ndotjen e ujrave nga deluvioneve.
- Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës.
- Punimet e mirëmbajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.
- Mirëmbajtja e vaskës dekantuese dhe ujërave që ndodhen në të.
- Monitorimi i vazhdueshëm mjedisor (ajër, zhurma, ujë) dhe raportimi periodik në organet kompetente.